



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. Prot.

Tiranë më, 19/04/2024

V E N D I M

Nr. 26, datë 19.04.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Ersa Karaj	Kryesues
Klevis Dhigoi	Relator
Erjana Pjetri	Anëtar

Asistuar nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Lediana Azemaj, më datë 19.04.2024, ora 10:00, në Tiranë, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, mori në shqyrtim në seancë e dhënies së vendimit çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:

Z. Hamdi Mehmet Fjora, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Forcës Kombëtare të Sigurisë, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AMP-së

Pasi dëgjoji gjetjet, bazuar në arsyetimin ligjor, si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes Klevis Dhigoi vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit z. Hamdi Fjora, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar,

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në vazhdim (AMP), është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Agjencisë Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi **Z. Hamdi Mehmet Fjora** është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit.

Subjekti i vlerësimit, **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin (nr.1, datë 18.04.2023), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Z. Klevis Dhigoi (**Relator**), Znj. Ersa Karaj (**Kryesuese**) dhe Znj. Erjana Pjetri (**Anëtare**).

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin (nr.01, datë 18.04.2023) vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**.

Relatori i çështjes, Z. Klevis Dhigoi nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar, datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë

e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 19.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.

Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.

Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, 42 dhe 46 të ligjit nr.12.2018, i ndryshuar, relatori i çështjes, ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit si më poshtë vijon:

- a. me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
- b. me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
- c. me Shkresën nr. *** prot., datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP-së deklaratën e kontrollit të figurës.

Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:










- ✚ Vlerësimin e pasurisë;
- ✚ Kontrollin e figurës;
- ✚ Vlerësimin e aftësive profesionale.

Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligjin 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
- b. Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- c. Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
- d. Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;



- e. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
- f. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

-  *Deklaratën e Pasurisë*
-  *Deklaratën për Kontrollin e Figurës*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet*
-  *Raportin e Vlerësimit të Pasurisë nga ILDKPKI*
-  *Raportin e Vlerësimit të Figurës nga AMP*
-  *Raportin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale nga DPPSH*
-  *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar*
-  *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*

Trupa e Vlerësimit ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

Trupa e Vlerësimit, më datë 06.03.2024 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Hamdi Fjora, me Vendimin Nr. **, datë 06.03.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Hamdi Fjora;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Hamdi Fjora, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 11.01.2024, subjekti i vlerësimit Hamdi Fjora, kërkoi konfirmimin në detyrë dhe Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin në seancën e dhënies së vendimit në datë 19.04.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

❖ Subjekti i vlerësi z. Hamdi Mehmet Fjora ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit të Vlerësimit nr.12.2018 (i ndryshuar);

❖ Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave edhe dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatori, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatorit.

IV – A) VLERËSIMI I PASURISË

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora** ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr. 12 index, viti 2023.

Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetur, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**.

A) I. DEKLARATA E PASURISË

Në zbatim të nenit 32, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit i nënshtrohet procesit të vlerësimit kalimtar për periudhën e vlerësimit të deklaratës së pasurisë nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaratimit të pasurisë. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

Pasuria nr 1.

Arë me sip. 10.800 m2, me nr. pasurie 154/1, Prezë, Tiranë.

Pjesa takuese: 50 %.

Vlera: 0 leke.

Burimi i krijimit: Trashëguar nga babai im M. F me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr. *** Akti, nr. *** Vendimi. Data e regjistrimit 01.03.2007. Në bashkëpronësi me vëllain tim.

Arë me sip. 3.400 m², me nr. pasurie *** Prezë, Tiranë.

Pjesa takuese: 50 %.

Vlera 0 leke.

Burimi i krijimit: Trashëguar nga babai im M. F me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr. *** Akti, nr. 2218 Vendimi. Data e regjistrimit 01.03.2007. Në bashkëpronësi me vëllain tim.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 02.03.2007, për pasurinë e llojit arë me sip. 10.800m², me nr. pasurie ***, në Prezë, Tiranë, regjistruar në emër të Hamdi dhe S. Fjora për ½ pjesë secili. + Kartela e pasurisë ku pasuria është regjistruar për vlerën 400.000 leke. + Harta treguese e regjistrimit.
- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 02.03.2007, për pasurinë e llojit arë me sip. 3.400m², me nr. pasurie ***, në Prezë, Tiranë, regjistruar në emër të Hamdi dhe S. Fjora, për ½ pjesë secili. + Kartela e pasurisë ku pasuria është regjistruar për vlerën 400.000 lekë. + Harta treguese e regjistrimit.
- ✓ Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), datë 22.06.1992, për familjen e M. F, nga fshati Prezë Kodër e sipërfaqes së tokës bujqësore prej 15.050 m², nga të cilat 10.800 m² toke art, 3.400 m², 550 m² vresht dhe 300 m² truall.
- ✓ Vendim nr. ***, dt. 20.04.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin M. F, i cili ka vendosur njohjen si trashëgimtar ligjor bashkëshorten N. F, vajzat H. A, D. K, F. H, V. Sh, S. K dhe djemtë K. F, S. F dhe Hamdi Fjora, të cilët përfitojnë 1/10 e pasurisë të trashëgimlënësit secili.

HETIMI ADMINISTRATIV

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kërkuar të dhëna nga institucione publike dhe private të cilat në bazë të ligjit janë të detyruara të japin të dhëna. ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u janë drejtuar institucioneve të mëposhtme:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës

- Drejtoritë Vendore në rreth dhe Zyrat Vendore të ASHK
- ISSH
- FSHU
- Shoqëritë Rajonale Ujësjiellës – Kanalizime.
- Regjistri Noterial Shqiptar
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- QKB.

Informacioni i dërguar nga këto institucione që japin të dhëna në interes të asetit të deklaruar janë si më poshtë:

ASHK sistemi online, konfirmon të regjistruar në emër të Hamdi dhe S. F, pasuritë me nr. *** dhe nr. ***, ne ZK. ****.

ASHK Tiranë - DV Zonat e Stimuluara, DV Tirana Jug, DV Tirana Rurale 1, DV Tiranë Rurale 2, DV Kamëz Vorë, me shkresat nr. *** prot., dt.150.6.2023, dt. 26.06.2023, 21.6.2023 dhe dt. 07.07.2023, nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit Hamdi Fjora dhe personave të lidhur.

Me postën elektronike datë 15.06.2023, subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se ketë pronë e ka trashëguar nga babai, i cili e ka përfitur me ligjin 7051, si familje bujqësore. Ne vitin 1992, kur u përfitua prona, familja përbëhej nga 4 (katër) anëtarë, babai, nëna, vëllai S. F dhe subjekti, Hamdi Fjora. Pas vdekjes së babait në vitin 2005 hapën një proces gjyqësor për trashëgiminë e pasurisë, por pavarësisht këmbënguljes që motrat dhe vëllai tjetër të mos përfshiheshin në trungun familjar dhe rrjedhimisht të mos ishin pjesëtarë të pasurive të përfituara me ligjin 7501, gjyqtari i çështjes vlerësoi se ata duheshin përfshirë dhe ne vendimin e gjykatës, janë 10 (dhjetë) trashëgimtarë. Motrat, vëllai dhe nëna, me prokurë te posaçme nr. *** rep, nr. *** kol, datë 01.02.2006, hoqën dorë pa asnjë kusht nga e drejta për të trashëguar pasuri nga burri, babai, i ndjeri M. F, si dhe shprehën vullnetin e tyre që prona të kalojë te dy trashëgimtarët e trungut familjar, Selami dhe Hamdi Fjora. Pas konsultimit me noterin, i'u sugjerua që për regjistrimin në hipotekë të pronës nuk mjaftonte vetëm prokura e heqjes dorë nga pasuria, por duhej të formalizohej edhe me një kontratë shit-blerje, për këtë arsye hartuan kontratat e shit-blerjes: nr. ***.rep, nr. ***.kol, dt. 26.02.2007; nr. ***.rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007; dhe nr. *** rep, nr.*** kol, dt. 01.02.2006. Aktualisht prona ka status tokë bujqësore dhe ata nuk kanë përfitime monetare prej saj.

Edhe për pasurinë truall 550m2 dhe vresht 300m2 (për kalimin e pronësisë) është proceduar në të njëjtën mënyre si më lart. Këto pasuri janë në pronësi të vëllait, S. F, sipas kontratave: nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007 dhe nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007. Lidhur me vlerën 400.000 lekë, që rezulton në kartelën e pasurisë subjekti deklaroi se kjo shumë nuk është paguar nga asnjë prej tyre dhe nuk ka përfitur askush një shumë të tillë.

Në inventarin nr. extra prot., datë 15.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Prokurë e posaçme nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 01.02.2006, ku shtetasit N. F, F. F (H), V. F (Sh), S. F (K), D. F (K), Xh. F (Z) dhe H. F (A), kanë caktuar si përfaqësues të posaçëm shtetasin Kujtim Fjora, të cilit i japin të drejtë që në emër dhe për llogari të tyre të paraqitet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të shprehur vullnetin e tyre për të hequr dorë përfundimisht dhe pa asnjë kusht nga e drejta për të trashëguar nga i ndjeri, M. F, të drejta të cilat shprehin vullnetin t'ia kalojnë dy trashëgimtarëve të tjerë, S dhe Hamdi Fjora.
- Certifikatë e trungut familjar, datë 28.01.2021, me gjendjen e datës 31.12.1995, në përbërjen e së cilës janë: M. F (kryefamiljari), N. F (bashkëshortja), S. F (i biri), dhe Hamdi Fjora (i biri).
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007, për pjesën e pandarë për pasurinë e llojit arë me sip. 10.800m², me nr. pasurie *** në Prezë, Tiranë. Shitës: V. F, D. K, F. H, N. F, K. D, H. A, Xh. Z dhe S. K. Blerës: S dhe Hamdi Fjora. Çmimi: 400.000 leke.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007, për pjesën e pandarë për pasurinë e llojit arë, me sip. 3.400m², me nr. pasurie 53/26 në Prezë, Tiranë. Shitës: V. F, D. K, F. H, N. F, K. D, H. A, Xh. Z dhe S. K. Blerës: S dhe Hamdi Fjora. Çmimi: 400.000 leke.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. ** kol, dt. 26.02.2007, për pjesën e pandarë për pasurinë e llojit truall, me sip. 300 m², nga kjo ndërtesë me sip. 98 m², me nr. pasurie 50/3/1 në Prezë, Tiranë. Shitës: V. F, D. K, F. H, N. F, K. F, H. A, Xh. Z, S. Ki dhe Hamdi Fjora. Blerës: S. F. Çmimi: 200.000 leke.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 26.02.2007, për pjesën e pandarë për pasurinë e llojit pemëtore me sip. 550m², me nr. pasurie 50/8 në Prezë, Tiranë. Shitës: V. F, D. K, F. H, N. F, K. F, H. A, Xh. Z, S. K dhe Hamdi Fjora. Blerës: S. F. Çmimi: 100.000 lekë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 02.03.2007, për pasurin e llojit truall me sip. 300m² nga kjo ndërtesë me sip. 98m², me nr. pasurie ****, Prezë, Tiranë, regjistruar në emër të S. F. + Hartë treguese + Kartelë e pasurisë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 05.03.2007, për pasurin e llojit pemëtore me sip. 550m², me nr. pasurie **, Prezë Tiranë, regjistruar në emër të S. F + Hartë treguese + Kartelë e pasurisë.
- Tabelë e pagesë se taksës së tokës bujqësore për periudhën 2011 – 2023.

Në inventarin nr. extra prot., datë 23.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. **** kol, dt. 21.06.2023, lëshuar nga shtetasit V. Sh, D. K, F. H, K. F, H. A, H. F dhe S. F, te cilët deklarojnë se së bashku me nënën e tyre të ndjerë N. F, i kanë shitur (dhuruar) pronat vëllezërve Hamdi dhe S Fjora, sipas kontratave nr. **** dhe ****, të cilat faktikisht i kanë dhuruar, por kanë bërë shitje formalisht vetëm për kalim pronësie, ato deklarojnë gjithashtu se mes tyre, nuk është shkëmbyer lekë as nga njëra palë.
- Postë elektronike e datës 22.06.2023, ku janë dërguar (2) deklarata nga S. K dhe Xh. Z, të dyja banuese në Itali, të cilat deklarojnë se kontratat e shitjeve bërë ndërmjet

vëllezërve dhe motrave, janë bërë formalisht, vetëm për kalim pronësie dhe mes tyre nuk është shkëmbyer lekë nga asnjëra palë, pra prona është e dhuruar.

Me postë elektronike datë 14.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se ndërtesa me sip. 98m² ne pronësi të vëllait S. Fjora, është ndërtesa ku subjekti ka lindur dhe është rritur, pra është banese e ndërtuar nga prindërit me kontributin e tyre.

Në inventarin nr. extra prot., datë 19.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku shpjegon se pasuria tokë, që ka në pronësi bashkë me vëllain, në origjinë të saj ka qenë babai dhe ligji 7501, prandaj kur ka deklaruar ndër vite, ka deklaruar trashëgiminë dhe dhurimin nga babai.
- Certifikatë familjare datë 19.07.2023, me gjendjen e përbërjes familjare të datës 01.08.1991, në përbërje të së cilës janë: M. F(kryefamiljari), N. F (bashkëshortja), S. F (i biri) dhe, Hamdi Fjora (i biri).

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Në vitin 1992, familja bujqësore e M. F (babait të subjektit), ka përfituar tokë bujqësore me sip. 15.050 m², nga të cilat: 10.800 m² tokë arë, 3.400 m² tokë arë 550 m² vresht dhe 300 m² truall. Sipas shpjegimeve të subjektit dhe certifikatës së trungut familjar të paraqitur prej tij, në vitin 1992, në përbërje të trungut familjar kanë qenë subjekti, nëna, babai dhe vëllai. Në vitin 2005 kur është bërë çelja e dëshmisë së trashëgimisë për babain, të ndjerin M. F, sipas vendimit gjyqësor, pasuritë e tij i kanë përfituar edhe fëmijët e tjerë. Duke qenë se fëmijët e tjerë, në momentin e marrjes së tokës me ligjin 7501, nuk ishin pjesë e përbërjes familjare, ata kanë rënë dakord që të heqin dorë nga pasuritë e përfituara me AMTP me anë të një deklaratë noteriale. Në këtë deklaratë ka hequr dorë edhe nëna e tyre. Sipas shpjegimeve të subjektit, regjistrimi i pronës nuk ishte i mundur me anë të deklaratës noteriale për heqje dorë nga pronësia, prandaj ata për efekt regjistrimi kanë lidhur kontrata shitblerje në vitin 2007, për të cilat deklaruar se shumatat e përcaktuara në kontratë nuk janë paguar mes tyre, pasi kontratat janë lidhur vetëm për efekt regjistrimi të pronësisë. Për këtë subjekti ka paraqitur edhe deklaratat të lëshuara nga motrat dhe vëllai i tij, të cilët konfirmojnë deklarinimet e subjektit. Në përfundim të këtyre transkriptimeve, subjekti ka marrë në bashkëpronësi me vëllain e tij, S. F, vetëm pasurinë e llojit arë, me sip. 10.800m² dhe arë me sip. 3.400m², ndërkohe që ka hequr dorë nga pjesa takuese për pasuritë e tjera vresht me sip. 550 m² dhe truall me sip. 300 m², në favor të vëllait, S. F.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI dhe trupa e vlerësimit pranë AMP-së, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- ✓ **Konfirmohet pasuria arë me sip. 10.800 m² + 3.400 m². në Prezë. Tiranë. në bashkëpronësi të subjektit dhe vëllait të tij, me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK online.**

- ✓ **Sipas dokumentacionit të paraqitur, këto pasuri janë përfituar me dhurim nga bashkëpronarët (heqje dorë nga bashkëpronësia). Ndërkohë subjekti në shpjegimet shtesë ka deklaruar se, kalimi i pronësisë është bërë me kontratë shitblerje të vitit 2007. Për këto pasuri subjekti ka paraqitur dy akte të ndryshme.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me origjinën dhe përfitimin e pronës.**

Pasuria nr 2.

Apartament me sip. 117,2 m2, nr. prone *****, Rr. "Muzakët", nd. **, ap. **, h. **, Tiranë.

Vlera: 500.000 lekë.

Pjesa takuese: 50%.

Data e blerjes: 15.01.2004. Data e regjistrimit: 21.01.2004.

Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat familjare 1991 – 2003.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.01.2004, për apartament me sip. 117,2m2, me nr. pasurie ***, në Rr. "Don Bosko", Tiranë. Blerës: Hamdi dhe Lindita Fjora. Shitës: L. K. Çmimi: 500.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr.****, dt. 23.01.2020, për pasurinë e llojit apartament me sip. 117,2 m2, me nr. pasurie ***, në Rr. "Muzakët", Tiranë, regjistruar në emër të Hamdi dhe Lindita Fjora, për ½ pjesë secili. + Kartela e pasurisë + Harta treguese e regjistrimit.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 19.11.2003, për apartament me sip. 117,2 m2, me nr. pasurie ***. Blerës: L. K. Shitës: Instituti i Sigurimeve INSIG. Çmimi: 31.609 USD, paguar jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim hipotekor nr. ***, dt. 05.12.2003, për pasurinë e llojit apartament, me sip. 117,2 m2, regjistruar në emër të L. K + Harta treguese e regjistrimit + Planimetria e apartamentit.
- Vërtetim hipotekor nr. ***, dt. 13.10.1995, për pasurinë e llojit apartament me sip. 117,2 m2, regjistruar në emër të shoqërisë Al-Mak + Harta treguese e regjistrimit + Planimetria e apartamentit.

Hetimi administrativ

ASHK Tirana Veri me shkresën nr. *** prot, dt. 26.06.2023, konfirmon se në emër të Hamdi Fjora është e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 117,20 m2, me nr. pasurie ***, në bashkëpronësi me Lindita Fjora. Sipas kartelës së pasurisë: shuma e regjistruar është 31.609 USD; hip.8/2004.

ASHK online konfirmon të regjistruar në emër të Hamdi dhe Lindita Fjora, pasurinë me nr. *** në ZK *****.

Me postë elektronike datë 15.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim ku ka deklaruar se vjehrra e tij, L. K, si punonjëse e INSIG, me datë 18.05.1998 ka lidhur kontratë me këtë të fundit, me objekt “Kontratë shitje me punonjësit”. Në këtë kontratë është përcaktuar mënyra e pagesës me këste ne bazë të “Librezës për shlyerjen e kësteve kredi dhënies”. Vlera e apartamentit është përcaktuar 31.609 USD. Shlyerja e kësteve ka vazhduar rregullisht deri ne vitin 2003, kur L. K është njoftuar nga INSIG se ishte në proces privatizimi dhe L. K si kliente e kredisë së banesave duhet të paraqitej për rakordimin e gjendjes së detyrimit, mbështetur kjo në të dhënat e kartelës personale dhe librezës së shlyerjeve. Pas rakordimit, me INSIG, sipas deklaramit të subjektit, vjehrra e tij ka blerë përfundimisht apartamentin në vitin 2003 dhe ka paguar në total për blerjen e tij një shumë prej 19.345 USD. Këtë apartament subjekti e ka blerë në vitin 2004 nga vjehrra e tij, me shumën 500.000 lekë, të cilën e kanë përballuar nga te ardhurat/kursimet e tyre familjare (lidhur me çmimin e blerjes prej vetëm 500.000 lekë, me postën elektronike datë 13.07.2023 dhe datë 14.07.2023, subjekti ka dërguar një deklaratë nga vjehrra L. K, e Cila deklaron se apartamenti është shitur me këtë çmim me rastin e martesës së vajzës së tyre. Për sa i përket ndryshimit të emërtimit të adresës së apartamentit nga rruga “Don Bosko” në rruga “Muzakët”, subjekti sqaroi se ky ndryshim është bërë nga adresari. Lidhur me shpenzimet e mobilimit për këtë apartament, shpjegoi se nuk ka kryer shpenzime, pasi apartamenti ka qenë i kompletuar nga prindërit e bashkëshortes, të cilët kanë jetuar në këtë banesë nga viti 1998 deri në vitin 2004, kur e ka blerë subjekti. Në vitin 2017, subjekti deklaron se ka blerë dhe zëvendësuar paisje elektroshtëpiake, me vlerë 123.760 lekë, sipas faturës se dyqanit Neptun në QTU, përballuar nga të ardhurat familjare.

Me inventarin nr.extra prot, datë 15.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarim rreth kontratës së shitjes për apartamentin me INSIG, nga L. K (vjehrra), ku sqaron lidhur me blerjen e apartamentit prej saj.
- Kontratë shitje me punonjësit, dt.18.05.1998, për apartament në Rr. “Don Bosko” Tiranë. Blerës: L. K. Shitës: INSIG. Çmimi: 31.609 USD, do të paguhet me këste për 20 vite (vërtetuar me vërtetim noterial nr. ** rep, nr. ** kol, dt. 08.06.1998).
- Librezë e INSIG për shlyerjen e kësteve të kredi dhënies, në emër të L. K, së bashku me pagesat e kryera për periudhën Janar 1999 - Maj 2003.
- Njoftim nga INSIG, nr. 3193 prot, dt. 26.06.2003, drejtuar L. K, ku njoftohet se duhet të paraqitet për rakordimin e gjendjes së mbetur të detyrimit të llogarisë debitore.
- Autorizim datë 03.09.2003, lëshuar nga INSIG për L. K, të paguaj vlerën prej 14.269 USD, e cila përbën shlyerjen e menjëhershme të vlerës së mbetur të çmimit të pronës, sipas kontratës së Shitjes, nr. ***, dt. 18.05.1998.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 19.11.2003, për apartament me sip.117,2 m2, me nr. pasurie ***. Blerës: L. K. Shitës: Instituti i Sigurimeve INSIG. Çmimi: 31.609 USD, paguar jashtë zyrës noteriale.

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr.*** kol, dt. 15.01.2004, për apartament me sip. 117,2m2, me nr. pasurie ***, ne Rr. “Don Bosko”, Tiranë. Blerës: Hamdi dhe Lindita Fjora. Shitës: L. K. Çmimi: 500.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, dt. 29.12.2003 + kartela e pasurisë, për apartament me sip. 69,2 m2, me nr. pasurie ****, “Rruga e Barrikadave” Tiranë, regjistruar në emër të R. K.
- Certificate për vërtetim pronësie, dt. 29.08.2012 + kartela e pasurisë, për apartament me sip. 69,2 m2, me nr. pasurie ***, “Rruga e Barrikadave”, Tiranë, regjistruar në emër të B. K.
- Vërtetim nr. *** prot, dt. 04.03.2021, lëshuar nga INSIG, për të ardhurat e L. K, për periudhën 1995 - 2000, në shumën neto 1.346.300 lekë.
- Vërtetim nr. **** prot, dt. 03.03.2021, lëshuar nga ILDKPKI, për të ardhurat e R. K, për periudhën Shtator 2003 - Tetor 2005, në shumën neto 2.558.938 lekë.
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar, për personin fizik L. K, me NIPT *****, me veprimtari “Projektme dhe zbatime të ndërtimeve...” regjistruar më datë 25.01.2005.
- Vërtetim page date 07.07.2009, referuese nga ISSH, për R. K, pranë ILDKPKI, në shumën 107.019 lekë.
- Vërtetim dt. 27.10.2005, lëshuar nga ILDKPKI, që vërteton se R. K ka punuar pranë këtij institucioni, për periudhën 08.09.2003 - 31.10.2005.
- Vërtetim nr.*** prot, dt. 06.09.2000, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, e cili vërteton se R. K, për periudhën 20.02.1998 - 20.02.2000, është trajtuar me pagesë kalimtare nga QKU.
- Vërtetim nr. **** prot, dt. 22.01.1998, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, e cili vërteton se R. K, për periudhën 16.10.1992 - 20.02.1998 ka qenë me detyrë jurist, në Aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes. Nga data 01.07.1993 - 16.12.1997 ka qenë me detyrë Shefi Byrosë Juridike.
- Certifikatë regjistrimi nr. ****, lëshuar nga Dega e Tatimeve Tiranë, për personin fizik R. K, regjistruar me Vendim Gjykate nr. ****, dt. 15.03.1999, për veprimtarinë “Avokat”.
- Deklaratë e lëshuar me emrin R. K, ku deklarohet periudha e punësimit të tij për periudhën 1983 deri në vitin 2009, kur ka dalë në pension dhe me emrin L. K, ku deklarohet periudha e punësimit të saj, për periudhën pas vitit 2001 deri në vitin 2021, si dhe të ardhurat e përfituara përafërsisht prej tyre.
- Faturë tatimore shitje dt.12.12.2017, nga shitësi NEPTUN sh.p.k, për Lindita Fjora, për parapagim në shumën 50.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje dt. 12.12.2017, nga shitësi NEPTUN sh.p.k, për Lindita Fjora, në shumën 123.760 lekë.

Me postë elektronike datë 14.07.2023 dhe datë 19.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se vlera e apartamentit, regjistruar në kartelën e pasurisë në ASHK, prej 31.609 (USD), është vlera e kontratës së shitblerjes, lidhur

ndërmjet INSIG dhe L. K. Kjo kontratë mban datën 19.11.2003. Kontrata e shitblerjes, ndërmjet subjektit dhe vjehrrës L. K, mban datën 15.01.2004. Në këtë kontratë është e pasqyruar shuma 500.000 lekë, shumë e cila është paguar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij. Gabimi në kartelë është bërë nga punonjësi i zyrës së regjistrimit të pasurisë. Kjo vërehet edhe nga fakti, se në kartelën e pasurisë, pasuria është regjistruar me dokument të vitit 2004, vit kur është lidhur edhe kontrata mes tij dhe vjehrrës, ndërkohë që kontrata e lidhur mes vjehrrës dhe INSIG i përket vitit 2003 dhe jo vitit 2004. Për sa shpjeguar, subjekti shton se deklaron me përgjegjësinë ligjore, se pasurinë apartament e ka regjistruar në ASHK sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.01.2004, në vlerën 500.000 lekë. Lidhur me deklaramet ndër vite, ku vlerën e apartamentit e ka shënuar 24.000 USD dhe 2.000.000 lekë, sqaroi se është lapsus i bërë nga pakujdesia në kohën e plotësimit të formularit. Gabime të bëra pa dashje dhe që nuk kanë pasur qëllim tjetër.

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. **** kol, dt. 19.11.2003, për apartament me sip. 117,2 m2, me nr. pasurie ***. Blerës: L. K. Shitës: Instituti i Sigurimeve INSIG. Çmimi: 31.609 USD, paguar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.01.2004, Për apartament me sip. 117,2m2, me nr. pasurie ***, ne Rr. “Don Bosko”, Tiranë. Blerës: Hamdi dhe Lindita Fjora Shitës: L. K. Çmimi: 500.000 lekë, paguar jashtë zyrës noteriale.

Me postë elektronike datë 27.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Kthim përgjigje datë 26.07.2023, nga ASHK Tirana Veri, drejtuar Hamdi Fjorës, ku e informon se u bë korrigjimi i kartelës së pasurisë, ku u pasqyrua gabimi i blerjes 500.000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. *** rep, nr.*** kol, dt. 15.01.2004.

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI. në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Vjehrra e subjektit, në vitin 1998 ka lidhur kontratë me INSIG për blerjen e një apartamenti në Tiranë, të cilin e ka blerë përfundimisht në momentin e privatizimit të kompanisë INSIG, në vitin 2003. Këtë apartament në vitin 2004, me rastin e martesës së vajzës së tyre, vjehrra i'a ka shitur subjektit dhe vajzës së saj, për vlerën 500.000 lekë, apartament i cili zotërohet aktualisht nga subjekti dhe bashkëshortja, ku dhe banojnë.

Si përfundim, Trupa e Vlerësimit, duke verifikuar përputhshmërinë e deklarameteve të subjekti me dokumentacionin e administruar, si dhe duke analizuar ligjshmërinë e mjaftueshmërinë nga ana financiare konkludoi se:

- ✓ **Konfirmohet apartamenti me sip. 117.2 m2 në Tiranë, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij. me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me origjinën dhe përfitimin e pronës në vitin 2004 dhe regjistrimin e tij në ASHK. Aseti është krijuar para vitit 2008.**

PASURI TË LUAJTSHME

Gjendje cash. Vlera 600.000 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: 300.000 lekë nga Shitja e automjetit me kontratë nr. **** rep, nr. **** kol, dt. 13.8.2018, në vlerën 300.000 lekë. 300.000 lekë kursime nga të ardhurat familjare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti, nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 09.02.2010, Për automjet Volkswagen. Blerës: Hamdi Fjora. Shitës: E. I. Çmimi: 3.000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. 4848 rep, nr. 3524 kol, dt. 13.08.2018, për automjet Volkswagen. Shitës: Hamdi Fjora. Blerës: M. G. Çmimi: 300.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, dt. 11.05.2023, konfirmon se Hamdi Fjora ka pasur të regjistruar në pronësi automjetin me targë AA*** VG (TR **** T).

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.
- ✓ Të ardhurat e realizuara justifikojnë gjendjen cash të deklaruar.

Pasuria nr 4.

Llogari page në Raiffeisen Bank. Data e balancës 01.03.2023. Vlera 14.668 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga.

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, konfirmon se Hamdi Fjora, në datë 08.03.2023, ka llogari page me gjendje 12.643 lekë.

Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 01.03.2023, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 08.03.2023.

Pasuria nr 5.

Automjet Mercedes Benz, prodhim i vitit 1986. Vlera 200.000 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Blerë më datë 06.10.2002, në shumën 1.700 euro dhe shitur më datë 19.02.2003, në shumën 200.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat familjare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti, dt. 06.10.2002, për automjet Mercedes Benz. Blerës: Hamdi Fjora. Shitës: O. O. Çmimi: 1.700 euro, i likuiduar.
- Kontratë shitblerje automjeti, dt. 19.02.2003, për automjet Mercedes Benz. Shitës: Hamdi Fjora Blerës: A. B. Çmimi: 200.000 lekë, i likuiduar.

Hetimi administrativ

- ✚ **DPSHTRR** me postën elektronike dt. 02.06.2023, konfirmon se Hamdi Fjora ka pasur të regjistruar në pronësi automjetin me targë TR **** F. Bashkëlidhur:
- Kontratë shitblerje automjeti, dt. 06.10.2002, për automjet Mercedes Benz. Blerës: Hamdi Fjora. Shitës: O. O. Çmimi: 1.700 euro, i likuiduar.
- Kontratë shitblerje automjeti, dt. 19.02.2003, për automjet Mercedes Benz. Shitës: Hamdi Fjora. Blerës: A. B. Çmimi: 200.000 lekë, i likuiduar.
- ✓ **Konstatohet se automjeti tip Mercedes Benz është blerë në vitin 2002 dhe shitur në vitin 2003.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

Automjet Volkswagen Golf, prodhim i vitit 1988.

Vlera: 250.000 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Blerë më datë 23.02.2004, në shumën 200.000 lekë dhe shitur më datë 26.01.2006, në shumën 250.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat familjare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti, dt. 23.02.2004, për automjet Volkswagen Golf, Blerës: Hamdi Fjora. Shitës: I. S. Çmimi: 200.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. ***rep, nr. *** kol, dt. 26.01.2006, për automjet Volkswagen Golf. Shitës: Hamdi Fjora. Blerës: G. B. Çmimi: 250.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Hetimi administrativ

DPSHTRR me postën elektronike dt. 02.06.2023, konfirmon se dosja e automjetit me targa TR **** I, ndodhet në Arkivin Kombëtar.

Me postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se automjeti është blerë me disa probleme teknike, të cilat subjekti i ka riparuar dhe e ka kthyer mjetin në gjendje pune. Deklaron se aktualisht nuk ka mjet në përdorim.

- ✓ **Konstatohet se automjeti tip Volkswagen Golf është blerë në vitin 2004 dhe shitur në vitin 2006.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

- ❖ **Automjet Volkswagen Passat**, prodhim i vitit 1998. Vlera 300.000 lekë. Zotërimi 100%. Blerë më datë 09.02.2010, në shumën 3.000 euro dhe shitur më datë 13.08.2018, në shumën 300.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat familjare.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti, nr. *** rep, nr. **** kol, dt. 09.02.2010, për automjet Volkswagen. Blerës: Hamdi Fjora. Shitës: E. I. Çmimi: 3.000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. **** rep, nr. **** kol, dt. 13.08.2018, për automjet Volkswagen. Shitës: Hamdi Fjora. Blerës: M. G. Çmimi: 300.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Leje qarkullimi dt. 15.02.2010, për automjet Volkswagen me targa TR **** T, regjistruar në emër të Hamdi Fjora.
- Certifikata e pronësisë e mjetit rrugor, datë 15.02.2010, për automjet Volkswagen me targa TR **** T, regjistruar në emër të Hamdi Fjora.

Hetimi administrativ

- 🚦 **DPSHTRR** me shkresën nr. *** prot, dt. 11.5.2023, konfirmon se Hamdi Fjora ka pasur te regjistruar në pronësi automjetin me targë AA *** KG (TR **** T). Bashkëlidhur.
- Kontrate shitblerje automjeti, nr. *** rep, nr. **** kol, dt. 09.02.2010, për automjet Volkswagen. Blerës: Hamdi Fjora. Shitës: E. I. Çmimi: 3.000 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje automjeti, nr. **** rep, nr. **** kol, dt.13.08.2018, për automjet Volkswagen. Shitës: Hamdi Fjora. Blerës: M. G. Çmimi: 300.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- ✓ **Konstatohet se automjeti tip Volkswagen Passat është blerë në vitin 2010 dhe shitur në vitin 2018.**
- ✓ **Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**

DEKLARIM I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga si komandat grupi dhe Shef Shtabi pranë repartit special RENE, Nëntor 1995 - Qershor 2004. Shuma 7.627.015 lekë.
- Të ardhura nga paga si Shef i zyrës se operacioneve në DPPSH, Qershor 2004 - Dhjetor 2005. Shuma 849.027 lekë.
- Të ardhura nga paga si Shefi i zyrës së operacioneve/drejtor i drejtorisë së FLO/zëvendës drejtor i përgjithshëm në DPPSH, Dhjetor 2005 - Shtator 2010. Shuma 5.130.881 lekë.
- Të ardhura nga paga si drejtor i Qendrës së Formimit Policor, Shtator 2010 - Shtator 2012. Shuma 1.974.145 lekë.
- Të ardhura nga paga si drejtor i drejtorisë së FLO dhe Shef sektori në DPPSH, Shtator 2012 – Prill 2014. Shuma 1.770.920 lekë.
- Të ardhura nga paga si drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, Prill 2014 - Nëntor 2014. Shuma 574.382 lekë.
- Të ardhura nga paga si Shef i Sektorit për Krimet ndaj Pronës në Drejtorinë për Krimet në DPPSH, Nëntor 2014 - Tetor 2016. Shuma 2.392.842 lekë.
- Të ardhura nga paga si Shef i Departamentit për Sigurinë Publike në Akademinë e Sigurisë, Nëntor 2016 - Janar 2018. Shuma 1.526.010 lekë.
- Të ardhura nga paga si Shef sektori në Drejtorinë e Studimeve Strategjike në DPPSH, Shkurt 2018 - Qershor 2018. Shuma 448.817 lekë.
- Të ardhura nga paga si zv/drejtor për Sigurinë Publike, DVP Korçë, Qershor 2018 - Qershor 2021. Shuma 3.963.217 lekë.
- Të ardhura nga kontrata individuale e punës me kohë të pjesshme me Arms School Academy, nga Janar 2019, kontrata ka qenë 4-vjeçare por me mirëkuptim midis palëve është ndërprerë në muajin e gjashtë. Shuma 240.000 lekë.
- Të ardhura nga paga si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, Korrik 2021 - Tetor 2021. Shuma 344.779 lekë.
- Të ardhura nga paga si Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Tetor 2021 - Dhjetor 2022. Shuma 1.705.117 lekë.
- Të ardhura nga paga si Drejtor i Drejtorisë së FLO, DPPSH. Shuma 149.342 lekë.
- Shuma e përgjithshme e të ardhurave 28.696.494 lekë. Nuk disponoj dokumentet për të ardhurat e mia nga paga e përfutur për periudhën Korrik 1991 - Tetor 1995. Periudhë kur kam shërbyer në repartet ushtarake në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank në emër të Hamdi Fjora, ku evidentohen kreditimet e pagave për periudhën 01.01.2020 - 30. 01. 2023.
 - Nxjerrje llogarie nga Tirana Bankë në emër të Hamdi Fjora, ku evidentohen kreditimet e pagave për periudhën 03.03.2011- 14.07.2014.
 - Vërtetim nga Raiffeisen Bank, mbi produktet e klientit Hamdi Fjora, për periudhën 2005 - 2019.
 - Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, dt. 10.12.2020, lëshuar nga ISSH, për Hamdi Fjora, për periudhën Prill 1994 - Tetor 1995, ne shumën 145.570 lekë.
 - Vërtetim page, lëshuar nga Drejtoria e Forcave Lëvizëse Operacionale, për Hamdi Fjora, për periudhën Nëntor 1995 - Qershor 2004, ne shumën 6.791.536 lekë.
 - Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare dt. 09.02.2021, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për Hamdi Fjora, për periudhën Qershor 2004 - Dhjetor 2005, në shumën neto 849.027 lekë.
 - Vërtetim të ardhurash nr. *** prot, dt. 21.02.2023, lëshuar nga Akademia e Policisë për Hamdi Fjora, për periudhën 2010 - 2012, në shumën neto 1.974.145 lekë.
 - Vërtetim për të ardhurat e përfituara nr. *** prot, dt. 21.02.2023, lëshuar nga Drejtoria vendore e Policisë Dibër, për Hamdi Fjora, për periudhën maj 2014 _nëntor 2014, në shumën neto 574.382 lekë.
 - Informacion i nxjerrë nga sistemi informatik i ISSH, për të ardhurat e Hamdi Fjora, për periudhën Maj 2012 - Nëntor 2019.
 - Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. *** prot, dt. 24.02.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë për Hamdi Fjora, për periudhën 11.06.2018 - 07.07.2021, në shumën neto 3.963,217 lekë.
 - Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Hamdi Fjora, ku evidentohen kreditimet e pagave për periudhën 05.01.2006 - 27.08.2010.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD, ku evidentohet se Hamdi Fjora, për periudhën 01.01.2006 - 02.02.2011 dhe 23.05.2014 - 02.03.2023, ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, etj., në shumën totale 17.596.532 lekë.
- ✚ **Tirana Bank** me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Hamdi Fjora ka përfituar te ardhura nga paga, dieta dhe rimbursime, për periudhën 03.03.2011 - 02.05.2014, në shumën totale 3.572.077 lekë.
- ✚ **ISSH** me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, për periudhën Maj 2012 - Mars 2023, ka përfituar të ardhura në institucionet: Qendra e Formimit Policor Tiranë; Akademia e Sigurisë; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; Komisariati i Policisë Dibër; Drejtoria e Policisë që Qarkut Korçë; Arms School Academy; Drejtoria Vendore e Policës Kukës; dhe Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër.

Me postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim ku ka deklaruar se veprimtaria e jashtme me kohë të pjeshme pranë Arms School Academy, ka qenë një veprimtari në fushën e mësimdhënies dhe të përgatitjes së kurikulave mësimore.
- ✓ **Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti dhe dokumentit të administruar, rezulton se subjekti Hamdi Fjora, për periudhën Prill 1994 - Mars 2023, ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, rimbursime, etj., në shumën rreth 28.955.000 lekë.**
- ✓ **Subjekti dha shpjegime lidhur me ushtrimin e veprimitarisë së jashtme.**

DETYRIME FINANCIARE

- Overdraft në Raiffeisen Bank, në shumën 180.000 lekë, i papërdorur. Qëllimi: për nevoja familjare.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, konfirmon se Hamdi Fjora, në datë 08.03.2023, ka llogari overdrafti me gjendje 180.000 leke.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

SHPENZIME TË DEKLARUESHME

I. Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese. ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022).

- Shpenzime për furnizimin me energji elektrike për periudhën Janar - Dhjetor 2022, sipas kontratës me nr. *****. Shuma 74.236 lekë.
- Shpenzime për furnizimin me ujë për periudhën Janar - Dhjetor 2022, sipas kontratës nr. *****. Shuma 34.783 lekë.
- Shpenzime për televizor dhe internet, për periudhën Janar - Dhjetor 2022. Shuma 46.680 lekë.
- Shpenzime për telefon celular, numri ***** , për periudhën Janar - Dhjetor 2022. Shuma 7.200 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Libreze energjie me OSHE me nr. D***** në emër të A. F, ku evidentohet se për periudhën Janar - Dhjetor 2022, janë paguar 69.235 lekë.

- Librezë energjie me UKT Tiranë me nr. *****, në emër të Hamdi Fjora, ku evidentohet se për periudhën Janar - Dhjetor 2022, janë paguar 34.783 lekë.

✚ Hetimi administrativ:

- ✚ **FSHU** me shkresën nr. *** prot, dt. 11.5.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Hamdi Fjora apo personave të lidhur, nuk rezulton të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike.
- ✚ **UKT Tiranë** me shkresën nr. *** prot, dt. 24.05.2023, konfirmon se për shtetasit Hamdi Fjora dhe personat e lidhur me të, nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata, të regjistruara në sistem.
- ✚ **DIGICOM sh.p.k.** me shkresën nr. *** prot, dt. 11.5.2023, konfirmon klientin Lindita Fjora, e cila ka marrë shërbime interneti dhe është faturuar me faturim mujor me vlerë 3.890 lekë, për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2022 dhe për periudhën 01.09.2022 - 31.12.2022, me faturim mujor me vlerë 3.790 lekë (total 46.280 lekë).
- ✚ **Vodafone Albania sh.a** me shkresën nr. *** prot, dt. 08.06.2023, konfirmon se klienti Hamdi Fjora, për faturat e celularit të numrin +35569*****, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, , ka shpenzuar 7.200 lekë.
Gjithashtu konfirmon se bashkëshortja e tij, Lindita Fjora, për faturat e celularit të numrit +35569*****, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, ka shpenzuar 11. 750 lekë.

Me postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se për vitin 2022, për faturat e celularit ka shpenzuar 7.200 lekë.

Me postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Fatura celulari me operatorin Vodafone sh.a., për klientin Hamdi Fjora, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, për periudhën Janar - Dhjetor 2022, me të cilat janë paguar në total 7.200 lekë
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e DIGICOM sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a.**
FSHU nuk e konfirmon kontratën në emrin e Hamdi Fjora. Sipas kontratës së paraqitur, emri në kontratë është shënuar Amdi dhe jo Hamdi.
UKT nuk e konfirmon kontratën në emrin e Hamdi Fjora.
- ✓ **Shpenzimet e deklaruar për energji elektrike, ujë, telefon dhe internet, për subjektin dhe personat e lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, janë në total rreth 169.000 lekë.**

II. Shpenzime për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin.

vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara: Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.

- Shpenzime për udhëtim në Mal të Zi, adresa: Luke Vukalovica, Njivice 85347. Datë e nisjes 23.04.2022 dhe kthimi me datë 25.04.2022. Udhëtim i organizuar nga agjencia turistike “Vataksi Travel Agency”. Shpenzimet janë përballuar nga kursimet familjare. Shuma 81.780 lekë.
- Shpenzime për pushimet verore në Turqi, hotel “Gloria Golf Resort”, Antalia, nga data 07.08.2022, deri në datë 15.08.2022. Shuma 2.570 euro.
- Shpenzime për udhëtimin e djalit në SHBA (bileta e avionit vajtje - ardhje). Shuma 103.274 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Rezervim hoteli në Mal të Zi, në emër të Hamdi, Lindita, J dhe D. Fjora, për periudhën 23.04.2022 - 25.04.2022.
- Faturë tatimore shitje dt. 14.02.2023, për blerësin Hamdi Fjora, nga shitësi D. V, në shumën 81.780 lekë.
- Rezervim hoteli në Turqi, në emër të Hamdi dhe Lindita Fjora, për periudhën 06.08.2022 - 15.08.2022, për shumën 2.570 euro.
- Rezervim fluturimi New York - Tiranë, për J. F, datë 02.08.2022.

Me postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se udhëtimi në Mal të Zi ka qenë me datë 23.04.2022, deri me datë 25.04.2022 dhe data 14.02.2023 e evidentuar në faturën tatimore të shitjes, është data e printimit të faturës tatimore sipas sistemit fiskal online, i cili në momentin e printimit të një fature të mëparshme gjeneron faturën në datën e momentit të printimit. Shpenzimet për këtë udhëtim janë përballuar me të ardhurat familjare, ashtu si dhe pushimet në Turqi.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti dha shpjegime lidhur me shpenzimet e udhëtimit në Mal të Zi, Turqi (udhëtimi i djalit në SHBA është trajtuar më poshtë).**
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për udhëtime/pushime për subjektin dhe personat e lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar janë në total 185.054 lekë dhe 2.570 euro, konvertuar rreth 480.000 lekë.**

III. Shpenzimet për arsimin e Fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve.

- Shpenzime për shkollimin e djalit në kolegjin Shqiptaro-Grek “Arsakeio” në Tiranë. Viti shkollor 2009 - 2010 dhe 2010 - 2011. Pagesa 3.260 USD, për arsimin dhe 96.000 lekë për transportin. Shpenzimet janë përballuar nga kursimet familjare.

- Shpenzime për shkollimin e djalit në kolegjin “Turgut Ozal”, në Tiranë, për vitin shkollor 2011 - 2012, 2012 - 2013, 2013 - 2014, 2014 - 2015, 2015 - 2016, 2016 - 2017, 2017 - 2018. Shpenzimet janë përballuar nga kursimet familjare. Shuma 7.699 euro.
- Shpenzime për shkollimin e vajzës në kolegjin “Turgut Ozal”, në Tiranë për vitin shkollor 2011 - 2012, 2012 - 2013, 2013 - 2014, 2014 - 2015, 2015 - 2016, 2016 - 2017, 2017 - 2018. Shpenzimet janë përballuar nga kursimet familjare. Shuma 10.495 euro.
- Shpenzime për shkollimin e djalit në shkollën “Protagonistët”, në Tiranë, për vitin shkollor 2018 - 2019, 2019 - 2020, 2020 - 2021. Shuma 440.277 lekë.
- Shpenzime për shkollimin e vajzës në shkollën “Protagonistët” në Tiranë, për vitin shkollor 2018 - 2019, 2019 - 2020, 2020 - 2021, 2021 - 2022, 2022 - 2023. Shuma 693.768 lekë.
- Shpenzime për shkollimin e djalit në Universitetin “Polis”, në Tiranë, për vitin shkollor 2021 -2022, 2022 - 2023. Shuma 267.807 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kthim përgjigje nr. **** prot, dt. 09.10.2020 nga kolegjii “Turgut Ozal”, ku konfirmon se J. F, për periudhën 2011 - 2017, ka paguar gjithsej 7.699 euro.
- Kthim përgjigje nr. **** prot, dt. 09.10.2020, nga kolegjii “Turgut Ozal”, ku konfirmon se D. F, për periudhën 2011 - 2017, ka paguar gjithsej 10.495 euro.
- Ditari i klientit J. F, nga Fondacionin “Fryma e Dashurisë” ku evidentohet se për periudhën 28.05.2018 - 09.10.2020, ka paguar 440.227 lekë.
- Urdhër transfertë në BKT, dt. 11.09.2018, ku evidentohet se L. K PF ka paguar për nxënësin J. F, në llogarinë e klientit “Fryma e Dashurisë”, shumën 152.000 lekë
- Urdhër transfertë në BKT, dt. 10.09.2019, ku evidentohet se L. K PF ka paguar për nxënësin J. F, ne llogarinë e klientit “Fryma e Dashurisë”, shumën 155.000 lekë.
- Urdhër transfertë në BKT, dt. 03.10.2020, ku evidentohet se L. K PF ka paguar për nxënësin J. F, në llogarinë e klientit “Fryma e Dashurisë” shumën 128.000 lekë.
- Ditari i klientit D. F, nga Fondacionin “Fryma e Dashurisë”, ku evidentohet se për periudhën 27.06.2018 - 06.02.2023, ka paguar 591.768 lekë dhe ka mbetur detyrim edhe 102.000 lekë.
- Faturë e thjeshtë tatimore nr. 114, dt. 10.09.2019, lëshuar nga Fondacioni “Fryma e Dashurisë” për D. F, në shumën 113.500 lekë.
- Faturë e thjeshtë tatimore nr. ***, dt. 10.09.2020, lëshuar nga Fondacioni “Fryma e Dashurisë” për D. F, ne shumën 142.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje nr. ***, dt. 06.02.2023, ku Dea Fjora ka paguar për Fondacionin “Fryma e Dashurisë”, një shumë prej 102.000 lekë.
- Faturë tatimore dt. 15.07.2021, ku blerësi Joni Fjora ka paguar për shitësin “Universiteti Polis”, një shumë prej 61.326 lekë.
- Mandat tërheqje ne BKT, dt. 11.04.2022, ku evidentohet se L. K , ka tërhequr një shume prej 60.700 lekë + Mandat në BKT, dt. 11.04.2022, ku L. K ka konvertuar një shumë prej 60.700 lekë në 500 euro + Mandat depozitimi dt. 11.04.2022, në RFZ Bank,

ku evidentohet se R. K ka depozituar për Universitetin Polis, një shumë prej 500 euro, pagesë shkolle për J. F.

- Faturë tatimore dt. 30.04.2022, ku blerësi J. F ka paguar për shitësin “Universiteti Polis”, një shumë prej 500 euro.
- Faturë tatimore dt. 19.10.2022, ku blerësi J. F ka paguar për shitësin “Universiteti Polis”, një shumë prej 1.250 euro.

Me proces-verbalin e datës 08.06.2023 dhe postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dhënë shpjegime, si dhe ka dërguar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim ku ka deklaruar se pagesat për arsimimin e djalit në shkollën “Arkasë” janë bërë sipas kontratës së lidhur me shkollën dhe shuma e paguar është 3.260 USD. Pagesat janë bërë me këste në bazë të kontratës. Subjekti deklaroi se nuk ka mundur të sigurojë dy fatura, ku janë paguar dy këste. Lidhur me detyrimin e shumës 102.000 lekë evidentuar në ditarin e pagesave për shkollën “Protagonistët”, subjekti sqaroi se ky detyrim është pagur në datë 06.02.2023, sipas faturës të po kësaj date, nr. 3084/2023. Për burimet financiare të përdorura për shkollat e fëmijëve deklaroi se janë përdorur të ardhurat familjare, ndërsa për burimet financiare të përdorura për pagesën e universitetit “POLIS”, për djalin Joni, subjekti sqaroi se ato janë kryer nga të ardhurat familjare por edhe nga gjyshja e djalit, L. K.

Me inventarin nr. extra prot datë 15.06.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Kontratë datë 01.09.2009, lidhur mes kolegjit Greko-Shqiptar dhe prindit të nxënësit J. F, Hamdi Fjora, për shkollimin dhe arsimin në klasën e parë. Pagesa vjetore 1.400 USD.
- Kontratë datë 20.09.2010, lidhur mes kolegjit Greko-Shqiptar dhe prindit të nxënësit J. F, Hamdi Fjora, për shkollimin dhe arsimin në klasën e dytë. Pagesa vjetore 1.550 USD.
- Mandat pagese në Tirana Bank, datë 19.06.2009, në shumën 400 USD, me përshkrimin “J. F, kësti i parë, klasa e parë, 2009 - 2010, depozituar nga Hamdi Fjora”.
- Mandat pagese në Tirana Bank, datë 07.10.2009, në shumën 500 USD, me përshkrimin “J. F, kësti i dytë, klasa e parë, viti 2009 – 2010”.
- Mandat pagese në Tirana Bank, datë 15.02.2010, në shumën 360 USD, me përshkrimin “J. F, kësti i katërt, klasa e parë, viti 2009 - 2010, depozituar nga Ismet Killogjeri”.
- Mandat pagese në Tirana Bank, datë 12.05.2010, në shumën 480 USD, me përshkrimin “J. F, kësti i parë viti 2010 - 2011, depozituar nga I. K”.
- Mandat pagese në Tirana Bank, datë 21.10.2010, në shumën 710 USD, me përshkrimin “J. F, kësti i dytë viti 2010 – 2011”.
- Mandat pagese në Tirana Bank, datë 25.02.2011, në shumën 391 USD, me përshkrimin “J. F, klasa e dytë, kësti i fundit, depozituar nga Hamdi Fjora”.

- Vërtetim nr. *** prot, dt. 04.03.2021, lëshuar nga INSIG për të ardhurat e L. K, për periudhën 1995 - 2000, në shumën neto 1.346.300 lekë.
- Vërtetim nr. **** prot, dt. 03.03.2021, lëshuar nga ILDKPKI për të ardhurat e R. K, për periudhën Shtator 2003 - Tetor 2005, në shumën neto 2.558.938 lekë.
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar, për personin fizik L. K, me NIPT K*****, me veprimtari "Projektme dhe zbatime të ndërtimeve... regjistruar më datë 25.01.2005.
- Vërtetim page referuese nga ISSH për R. K, pranë ILDKPKI, në shumën 107.019 lekë.
- Vërtetim dt. 27.10.2005, lëshuar nga ILDKPKI, ku vërtetohet se R. K ka punuar pranë këtij institucioni për periudhën 08.09.2003 - 31.10.2005.
- Vërtetim nr. ** prot, dt. 06.09.2000, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, i cili vërtetohet se R. K, për periudhën 20.02.1998 - 20.02.2000, është trajtuar me pagesë kalimtare nga QKU.
- Vërtetim nr. **** prot, dt. 22.01.1998, lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, i cili vërtetohet se R. K, për periudhën 16.10.1992 - 20.02.1998 ka qenë me detyrë jurist në Aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes. Nga data 01.07.1993 - 16.12.1997 ka qenë me detyrë Shefi Byrosë Juridike.
- Certifikatë regjistrimi nr. ****, lëshuar nga Dega e Tatimeve Tiranë, për personin fizik R. K, regjistruar me Vendim Gjykate nr. ****, dt. 15.03.1999, për veprimtarinë "Avokat".
- Deklaratë e lëshuar me emrin R. K, ku deklarohet periudha e punësimit të tij për periudhën 1983 deri në vitin 2009, kur ka dalë në pension dhe me emrin L. K, ku deklarohet periudha e punësimit të saj për periudhën pas vitit 2001 deri në vitin 2021, si dhe të ardhurat e përfituara për afërsisht prej tyre.
- Kthim përgjigje nr. **** prot, dt. 25.02.2020, nga DRT Tiranë për shtetasin R. K dhe subjektet tregtare R. K dhe L. K, sipas së cilës: R. K është i regjistruar në DRT Tiranë për përgjegjësinë tatimore DIVA (Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave) . Nga verifikimi R. K nuk ka deklaruar DIVA (Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave) për periudhën 2015 - 2018. Subjekti tregtar R. K me NIPT L*****, ka kaluar me status çregjistruar më datë 03.03.2017. për periudhën 2015 - 2017, subjekti tregtar ka pasur 60.774 lekë fitim dhe 165.085 lekë humbje. DRT Tiranë konfirmon gjithashtu se subjekti tregtar L. K me NIPT K***** për periudhën 2006 - 2019, ka pasur fitim pas tatimit në shumën 26.958.938 lekë.

Me postën elektronike datë 14.07.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim ku ka deklaruar se emri i shtetasit I. K, në mandatin e lëshuar nga banka, gjendet pasi ketë shtetas e ka dërguar subjekti për të kryer pagesën. Shtetasi I. K, në atë periudhë ka qenë punonjës në Ministrinë e Brendshme, me detyrën e shoferit pranë Drejtorit të Forcave Speciale dhe Ndërhyrjes së Shpejtë. Të gjitha pagesat për shkollimin e djalit në kolegjin Shqiptaro-Grek, janë mbuluar nga kursimet familjare.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti dha shpjegime lidhur me shpenzimet e arsimimit të fëmijëve.
 - ✓ Shpenzimet e deklaruara për arsimin e fëmijëve, për periudhën 2009 - 2023, janë në total 1.497.852 lekë + 18.194 euro + 3.260 USD konvertuar rreth 3.935.000 lekë (nga të cilat 500 Euro janë paguar nga nëna e bashkëshortes).
- ❖ Shpenzime për aplikimin dhe regjistrimin e djalit në programin “Work and Travel US”. Program i cili mundëson studentët për të punuar gjatë sezonit veror në SHBA. Shuma 1.530 USD.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Mandat bankar nga ISP Bank, ku evidentohet se në dt. 17.05.2022, Lindita Fjora ka depozituar cash një shumë prej 1.530 USD, me përshkrimin “J. F, pagese për program Work and Travel US”.
 - Mandat bankar nga BKT, ku evidentohet se në dt. 14.06.2022, J. F= ka depozituar cash një shumë prej 19.100 lekë për E. D, me përshkrimin “pagesë për intervistë J1 Work and Travel visa”.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Shpenzimet e udhëtimit për punësim sezonal të djalit J. F në USA, në vitin 2022, janë 1.530 USD, konvertuar në total rreth 166.000 lekë.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - LINDITA FJORA

DEKLARIMI I PASURIVE

- ❖ **Apartament** me sip. 117,2 m2, nr. prone *****, Rr. "Muzakët", nd. **, ap. **, h. **, Tiranë.

Vlera: 500.000 lekë.

Pjesa takuese: 50%.

Data e blerjes: 15.01.2004. Data e regjistrimit: 21.01.2004.

Burimi i krijimit: Kursime nga të ardhurat familjare 1991 – 2003.

- ✓ **Trajtuar më sipër.**
- ❖ **Depozitë në Intesa SanPaolo Bank**, datë 23.02.2023. Vlera 5.000 euro + 404 euro (interes).

Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Dhurim. Transferuar nga R. K te Lindita Fjora.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Pozicioni i përgjithshëm i klientit nga Intesa SanPaolo Bank, në emër të Lindita Fjora, ku evidentohet se gjendja në depozitë, në dt. 23.02.2023, është 5.404 euro.
- Nxjerrje llogarie nga Intesa SanPaolo Bank, ku evidentohet se në datë 13.09.2010, shtetasi R. K ka transferuar në llogarinë e Lindita Kruja një shumë prej 5.000 euro.

Hetimi administrativ:

- ✚ **ISP Bank** me shkresën nr. *** prot, dt. 15.05.2023, konfirmon se Lindita Fjora, në datë 08.03.2023, ka depozitë me gjendje 5.404 euro. Kjo shumë ka si burim financiar një transferim prej 5.000 euro nga R. K, në datë 13.09.2010.
- ✚ **QKB**, me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, konfirmon se:
 - R. K, dt. 03.01.1945, figuron të ketë qenë i regjistruar si person fizik, pajisur me NIPT L*****. Aktualisht subjekti figuron me status regjistruar.
 - R. K, dt. 03.10.1945, figuron si Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në subjektin “I. S. P INT” sh.a. me NIPT K*****. Aktualisht subjekti rezulton me status pezulluar.
 - L. K, dt. 28.02.1951, figuron të ketë qenë i regjistruar si person fizik, pajisur me NIPT K*****. Aktualisht subjekti figuron me status Aktiv.
- ✚ **DPT** me shkresën nr. **** prot, dt. 27.04.2023, konfirmon se:
 - R. K, është i regjistruar si tatimpagues në DRT Tiranë, me NIPT L*****.
 - L. K, është e regjistruar si tatimpaguese në DRT Tiranë, me NIPT K*****.
- ✚ **ISSH** me shkresën nr. **** prot, dt. 10.05.2023, për periudhën Maj-Tetor 2015 - Dhjetor 2016, ka të dhëna për pagesën e kontributeve për R. K, pranë subjektit tregtar ”R. K me NIPT L*****. Gjithashtu konfirmon se R. K prej muajit Prill 2009, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 33.423 lekë. ISSH konfirmon edhe se L. K për periudhën Janar 2012 - Dhjetor 2022, ka paguar kontributet pranë subjektit tregtar ”L. K”, me NIPT K*****. Prej muajit Shkurt 2010, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 26.294 lekë dhe pension suplementar shtetëror me masë mujore aktuale 4.515 Lekë.
- ✚ **ISSH, Dega e Arkivit Tiranë**, me shkresën nr. **** prot, dt.16.05.2023, konfirmon se L. B (K) ka të dhëna punësimi për periudhën 1969 - 1992.
- ✚ **DRT Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, dt, 21.06.2023, konfirmon se R. K, rezulton i regjistruar si person fizik, me NIPT L*****, i regjistruar në sistemin tatimor C@TS, më datë 01.10.2015. Sipas të dhënave të deklaratave të dt. ardhurave të dorëzuara ne sistemin C@TS, xhiro e deklaruar dhe fitimi i realizuar janë si me poshtë:

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Humbja	Fitimi pas tatimit
------	------------	--------	--------	--------------------

2015	387.300	67.024		67.024
2016	1.318.100		165.085	

DRT Tiranë, konfirmon gjithashtu se L. K, rezulton e regjistruar si person fizik me NIPT K*****, e regjistruar në sistemin C@TS me datë 16.05.2006. Sipas te dhënave të deklaratave të të ardhurave të dorëzuara në sistemin C@TS, xhiro e deklaruar dhe fitimi i realizuar janë si me poshtë:

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Humbja	Fitimi pas tatimit
2008	1.800.000	1.800.000		1.620.000
2009	1.320.500	500.000		450.000
2010	5.069.630	1.539.448		1.385.503
2011	2.457.684	236.907		213.216
2012	2.768.244	1.576.460		1.418.814
2013	3.623.333	1.788.870		1.609.983
2014	3.556.668	2.780.542		2.572.001
2015	2.918.334	2.516.776		2.328.018
2016	4.405.834	3.838.583		3.838.583
2017	3.171.669	2.822.384		2.822.384
2018	5.254.167	4.848.117		4.605.711
2019	4.456.057	4.044.725		4.044.725

2020	2.663.334	2.275.611		2.275.611
2021	2.892.000	2.509.285		2.509.285
2022	3.178.000	2.801.764		2.801.764

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ISP Bank.**
- ✓ **Nga dokumentacioni i administruar rezulton se L. K, për periudhën 2008 -2022, nga aktiviteti privat i saj ka pasur fitim në shumën rreth 34.496.000 lekë, ndërsa aktiviteti privat i R. K ka rezultuar me humbje.**
- ❖ **Llogari page në Raiffeisen Bank**, datë 01.03.2023. Vlera 402.993 lekë.
Zotërimi: 100%.
Burimi i krijimit: Kursime nga paga (transfertë bashkëshortore) dhe të ardhura nga titulli ekzekutiv vendim nr. 4442, dt. 24.07.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë në fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, konfirmon se Lindita Fjora, në datë 08.03.2023, ka llogari page me gjendje 410.417 lekë.
- ✓ **Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 01.03.2023, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 08.03.2023.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga si specialiste pranë shoqërisë “Enval” sh.p.k., Mars 2004 - Korrik 2004, Tetor 2006 - Nëntor 2010. Shuma 1.167.301 lekë.
- Të ardhura nga paga si specialiste pranë shoqërisë “Artend” sh.p.k., Gusht 2004 - Dhjetor 2004. Shuma 65.000 lekë
- Të ardhura nga paga si specialiste pranë shoqërisë “Dita 2000” sh.p.k. Shuma 137.689 lekë.
- Të ardhura nga paga si specialiste pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Ministria e Mjedisit. Shuma 1.448.942 lekë.
- Të ardhura nga paga si specialiste pranë shoqërisë “Alb Tipografia” sh.p.k. shuma 189.454 lekë.

- Të ardhura nga paga, trajtuar sipas VKM nr.183, dt. 09.02.2011 “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë Së Shtetit për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”. Shuma 3.804.000 lekë.
- Të ardhura nga paga, kursime nga paga (transfertë bashkëshortore) dhe të ardhura nga titulli ekzekutiv Vendim nr. ****, dt. 24.07.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, lënë ne fuqi nga vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë. Shuma 402.993 lekë.
- Shuma totale e të ardhurave 7.215.379 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Informacion i nxjerrë nga sistemi informatik i ISSH, për të ardhurat e Lindita Fjora, për periudhën Dhjetor 2012 - Dhjetor 2022.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. *** prot, dt. 24.02.2023, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, për Lindita Fjora për periudhën 11.06.2018 - 07.07.2021, në shumën neto 1.250.850 lekë.
- Kthim përgjigje nr. **** prot, dt. 24.12.2019, dërguar nga Union Bank, që konfirmon se Lindita Fjora ka qenë klientë pranë kësaj banke, duke bashkëlidhur edhe CD.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. *** prot, dt. 01.02.2023, lëshuar nga ISSH, për Lindita Fjora, për periudhën Gusht 2004 - Dhjetor 2004, pranë subjektit “Artend”, në shumën neto 65.000 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nr. *** prot, dt. 01.02.2023, lëshuar nga ISSH, për Lindita Fjora, për periudhën Tetor 2005 - Shtator 2006, pranë subjektit “Dita 2000”, në shumën neto 137.689 lekë.
- Vërtetim nga Raiffeisen Bank, mbi produktet e klientit Lindita Fjora, për periudhën 2014 - 2019.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare dt. 01.02.2023, nga ISSH, për Lindita Fjora, për periudhën Mars 2004 - Korrik 2004 dhe Tetor 2006 - Dhjetor 2007, pranë subjektit “Enval” sh.p.k, në shumën neto 370.290 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare dt. 01.02.2023, nga ISSH, për Lindita Fjora, për periudhën Janar 2008 - Nëntor 2010, pranë subjektit “Enval” sh.p.k., në shumën neto 797.011 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për Lindita Fjora, për periudhën 03.03.2011 - 27.05.2016, ku evidentohet kreditimi i pagave.

Hetimi administrativ:

- ✚ **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 23.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Lindita Fjora ka përfiturar të ardhura nga paga, për periudhën 03.03.2011- 12.03.2014, në shumën totale 1.397.836 lekë.
- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD, ku evidentohet se Lindita Fjora ka përfiturar të ardhura nga paga, për periudhën 03.10.2014

- 02.03.2023, në shumën totale 3.370.333 lekë, gjithashtu evidentohet se gjatë vitit 2016, ka përfituar edhe një shumë prej 942.470 lekë, sipas ekzekutimit të Vendimit nr. 4442, dt. 24.07.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

✚ **Union Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 23.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet se Lindita Fjora ka përfituar të ardhura nga paga, për periudhën 03.12.2010 - 08.02.2011, në shumën totale 64.922 lekë.

✚ **ISSH**, me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, për periudhën Dhjetor 2012 - Mars 2023, konfirmon se Lindita Fjora ka përfituar të ardhura në institucionet: Drejtoria e Shërbimit Pyjor; ALB-TIPOGRAFIA; Komisarati i Policisë Dibër; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; Akademia e Sigurisë; Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë; Drejtoria Vendore e Policisë Kukës; dhe Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër.

✚ **ISSH, Dega e Arkivit Tiranë**, me shkresën nr. *** prot, dt. 16.05.2023, konfirmon se Lindita Fjora ka të dhëna punësimi pranë: “Enmel” sh.p.k, filluar më datë 01.03.2004 dhe larguar më datë 31.07.2004, rifilluar më datë 01.10.2006 dhe larguar më datë 18.11.2010; si dhe pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, filluar më datë 19.10.2010 dhe larguar më datë 21.02.2014.

Me postën elektronike datë 15.06.2023. subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim ku ka deklaruar se shuma 402.993 lekë e deklaruar në Raiffeisen Bank është balanca e mbetur në llogarinë rrjedhëse, datën që ka bërë deklarinimin nga shuma prej 942.470 lekë e përfituar nga vendimi i gjykatës, hedhur në numrin e llogarisë rrjedhëse të bashkëshortes, në të cilën hidhen edhe pagat mujore të saj. Tërheqja e parave nga kjo llogari është bërë për përbalimin e shpenzimeve familjare.

Me inventarin nr. extra prot., datë 15.6.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 24.2.2023, për llogari në emër të Lindita Fjora.

Me postën elektronike datë 01.03.2024. i pyetur nga relatori i çështjes në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes sipas VKM-së nr.183, dt. 09.02.2011, subjekti ka dhënë sqarime:

VKM nr.183, dt. 09.02.2011 “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë Së Shtetit për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”, parashikon kompensimin e bashkëshortes/it, kur kjo humb vendin e punës si pasojë e transferimit në detyrë jashtë vendbanimit.

Konkretisht unë jam transferuar në DVP Dibër me urdhër Nr, ****, datë 25.04.2014, të Drejtoritë të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe si rezultat i këtij transferimi, bashkëshortja ime zj. Lindita Fjora ka humbur vendin e punës.

Me zhvendosjen tonë në Dibër, bashkëshortja ka kryer aplikimet për punësim në këtë qark pranë zyrës së punësimit.

Me përgjigjen negative të kësaj zyre (nuk ka vende pune të lira) bashkëshortja i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, për trajtim me pagë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të lart përmendur.

Edhe aktualisht bashkëshortja ime vazhdon të trajtohet në bazë të këtij vendimi.

Bashkëlidhur dokumentacioni ligjor.

- ✓ **Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti dhe dokumentit të administruar, rezulton se bashkëshortja Lindita Fjora, për periudhën Prill 2004 - Mars 2023, ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, eti.. në shumën rreth 6.203.000 lekë, si dhe nga vendimi gjyqësor, një shumë prej rreth 942.000 lekë.**

DEKLARIMI I DJALIT – JONI FJORA

DEKLARIMI I PASURIVE

- ❖ **Depozitë në Raiffeisen Bank**, date 24.03.2022.

Vlera: 100.000 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: Dhurim nga gjyshi R. K më date 25.06.2021.

- ✚ **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, konfirmon se Joni Fjora, në datë 08.03.2023, ka llogari rrjedhëse me gjendje 96.337 lekë. Kjo shumë ka si burim financiar një transferim prej 100.000 lekë nga R. K, në datë 25.06.2021.

- ✓ **Konfirmohet deklарimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**
- ✓ **Shpjegimet dhe dokumentet justifikuese për burimet financiare të shtetasve Remzi dhe L. K janë evidentuar më sipër.**

- ❖ **Depozitë në Chase banker**, Shelter Island, SHBA. Vlera 1.639 USD. Zotërimi 100%.
Burimi i krijimit: Page e përfituar nga puna e kryer në restorant “Wine Street Cafe”.
Jam punësuar nëpërmjet programit “Summer Travel/Work”, program i cili mundëson udhëtimin dhe punësimin për studentët gjatë sezonit veror.

Me postën elektronike datë 15.06.2023, subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku ka deklaruar se akomodimi i djalit në SHBA është siguruar nga punëdhënësi i tij atje. Gjendja e llogarisë e deklaruar prej 1.639 USD ka qene gjendja në datën e deklarimit të pasurisë. Djali ka printuar nga llogaria i tij gjendjen e llogarisë më datë 13.06.2023, e cila është 1.484 USD, por datën e mëparshme nuk mund ta gjenerojë. Gjendja aktuale prej 1.484 USD është pasi djali ka kryer disa blerje on-line.

Me inventarin nr.extra prot., datë 15.06.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Printim gjendje llogarie bankare (Chase College), në vlerën 1.484 USD.

Me inventarin nr.extra prot., datë 23.06.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Certifikatë e përshtatshmërisë për statusin e vizitorit të shkëmbimit (jo emigrant), lëshuar nga Departamenti i Shtetit në SHBA, për Joni Fjora, për programin Travel/Work, për periudhën 20.07.2022 - 01.10.2022, me adresë “Vine Street Cafe 41 South Farry Rd Shelter Island, NY 11964”.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti dha shpjegime për punësimin dhe qëndrimin e djalit në SHBA.**

DEKLARIM I TË ARDHURAVE

- Të ardhura të përfituara nga puna e kryer në restorant “Wine Street Cafe”, adresa: 41 South Ferry Rd, Shelter Island NY 1 1964. Korrik - Shtator 2022, nëpërmjet programit “Summer Travel/Work”, program i cili mundëson udhëtim dhe punësim për studentet gjatë sezonit veror, jam punësuar në SHBA dhe kam përfituar 3.020 USD nga të cilat kam depozituar në bankë shumën 1.639 USD.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Çek bankar, datë 31.7.2022, në emër të Joni Fjora, në shumën 413 USD.
- Çek bankar, datë 14.08.2022, në emër të Joni Fjora, në shumën 514 USD.
- Çek bankar, datë 04.09.2022, në emër të Joni Fjora, në shumën 551 USD.
- Çek bankar, datë 7.08.2022, në emër të Joni Fjora, në shumën 278 USD.
- Çek bankar, datë 28.08.2022, në emër të Joni Fjora, në shumën 776 USD.
- Çek bankar, datë 21.08.2022, në emër të Joni Fjora, në shumën 487 USD.
- Marrëveshje depozitë/llogarie datë 23.08.2022, për Joni Fjora, në bankën JP Morgan Chase Bank.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

- ✓ Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti rezulton se djali Joni Fjora ka përfituar të ardhura nga punësimi sezonal në SHBA, gjatë periudhës Korrik-Shtator 2022 rreth 3.019 USD.

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Hamdi Fjora ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon: “Njësia Bashkiake nr. 9”, Rr. ”Muzakët”, Ndërtesa 28, Ap. 7, Hyrja 26, Kodi Postar 1016, Tiranë.

- ✚ Union Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 23.05.2023, si adresë të klientit Lindita Fjora, ka të regjistruar: Pall. **, Ap. **, “Rruga e Barrikadave”, Tiranë.

Me postën elektronike datë 15.06.2023, subjekti ka dërguar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim ku deklarohet se adresa e konfirmuar nga Union Bank: “Rruga e Barrikadave”, Tiranë, ka qenë adresa e banesës së prindërve të bashkëshortes, banesë e cila aktualisht është në pronësi të vëllait të bashkëshortes, Bledar Kruja (i cili i’ka kishte lënë subjektit në përdorim, me akt përdorimi në vitin 2015, për 1 vit). Kjo banesë është përfituar nga prindërit e bashkëshortes, nëpërmjet privatizimit. Për sa i përket adresës “Prezë” e evidentuar kjo në faturën tatimore të datës 14.02.2013 (evidentuar në shpenzimet e udhëtimeve) që janë paguar për pushimet në Mal të Zi, subjekti sqaroi se kjo nuk është adresa banimit, por vendlindja e tij sipas kartës së identitetit.

Me inventarin nr.extra Prot. datë 15.06.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Kontratë huapërdorje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 11.02.2015, lidhur mes B. K dhe Hamdi Fjora, për apartament banimi, me afat 12 muaj.

Me inventarin nr.extra Prot., datë 19.07.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim ku deklarohet se arsyeja pse ka banuar në apartamentin e vëllait të bashkëshortes, të ndodhur në “Rruga e Barrikadave” ka qenë se në apartamentin e subjektit kishte rrjedhje të ujit nga një kat më sipër dhe derisa komshiu bëri ndërhyrje duke eliminuar problemin, kanë banuar në apartamentin e kumatit. Gjithashtu shtoi se gjendjen civile e ka pasur të regjistruar në këtë adresë edhe në vitet e para të martesës.

Me postën elektronike të datës 27.07.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- Sqarime me shkrim, ku deklarohet se gjatë periudhës që ka ushtruar detyrën si punonjës i Policisë së Shtetit jashtë qytetit të Tiranës, është akomoduar dhe ka banuar në ambientet e punës. Vetëm në qytetin e Peshkopisë ka banuar me qira për një periudhë

të shkurtër kohe dhe pasi janë krijuar kushtet, ka banuar në ambientet e Drejtorisë së Policisë Dibër. Në qytetet Korçë dhe Shkodër, për ditët që ka punuar atje, është akomoduar në zyrën e tij. Kostot e qirasë i ka përballuar me të ardhurat e tij.

- Kontratë qiraje nr. **** rep, nr.**** kol, datë 16.09.2014, për apartament në qytetin e Peshkopisë. Qiramarrës : Hamdi Fjora. Qiradhënës: A. I. Qiraja: 5.000 lekë/muaj. Afati: 2 vjet.

- ✓ **Rezulton se adresa e deklaruar i përket banesës në pronësinë e subjektit, trajtuar më sipër. Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion lidhur me adresat e banimit ku ka jetuar ndër vite, gjatë ushtrimit të detyrës jashtë qytetit të Tiranës, si dhe për adresën e evidentuar në “Rruga e Barrikadave”.**

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar deri në datë 08.03.2023, si më poshtë:

1.	Arë me sip. 10.800 m2, në Prezë, Tiranë. Vlera 0 lekë. Zotëruar nga subjekti dhe vëllai i tij me 50% secili. Përfiturar me AMTP dhe nga familjarët e tyre.
2.	Arë me sip. 3.400 m2, në Prezë, Tiranë. Vlera 0 lekë. Zotëruar nga subjekti dhe vëllai i tij me 50% secili. Përfiturar me AMTP dhe nga familjarët e tyre.
3.	Apartment me sip. 117,20 m2, Tiranë. Blerë në vitin 2004 me çmimin 500.000 lekë. Zotëruar nga subjekti 50% dhe bashkëshortja 50%.
4.	Gjendje cash 600.000 lekë. Zotërimi 100%.
5.	Llogari page në RFZ Bank në emër të subjektit. Vlera 14.668 lekë.
6.	Depozitë në ISP Bank në emër të bashkëshortes, në vlerën 5.404 euro.
7.	Llogari page në RFZ Bank në emër të bashkëshortes. Vlera 402.903 lekë.
8.	Depozitë në RFZ Bank në emër të djalit, në vlerën 100.000 lekë.
9.	Depozitë në Chase Bank (SHBA) në emër të djalit, në vlerën 1.639 USD.
10.	Overdraft në RFZ Bank në emër të subjektit, në vlerën 180.000 lekë (i papërdorur).

- ✚ **Banka e Shqipërisë, BKT, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka ProCredit Bank, Fibank, Abi Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, LandesLease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar, AK Invest, EasyPay, Fondi Besa, NOA sha, IUTE CREDIT sha, Kred.al, 15 Shoqëri Rajonale të UK, ONE Albania, Albanian Satellite Communication sh.p.k., Abissnet,** konfirmojnë se subjekti dhe persona e lidhur me të, nuk janë klient të tyre, çka përputhet me deklarinimin e tij.

- ✚ **ASHK, Zyrat/Drejtoritë Vendore - Librazhd, Mallakastër, Devoll, Korçë, Fier, Berat, Lezhë, Lushnjë, Krujë, Kuçovë, Gjirokastër, Tirana Jug, Malësi e Madhe Kukës, Kavajë, Bulqizë, Skrapar, Kolonjë, Elbasan, Peqin, Tropojë, Tepelenë, Përmet,**

Mirditë, Sarandë, Dibër, Pogradec, Vlorë, Dibër, Shkordër, Kurbin, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit apo personave të lidhur.

- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën ***** prot., datë 10.05.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit ose personave të lidhur me të.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;

- ✓ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 08.03.2023, është deklaruar bruto/neto **1.617.571 lekë + 5.404 Euro + 1.639 USD** e konvertuar rreth **2.415.000 lekë**.
- ✓ Të ardhurat e subjektit konfirmohen në vlerën totale rreth **28.955.000 lekë**.
- ✓ Të ardhurat e bashkëshortes, konfirmohen në vlerën totale rreth **7.145.000 lekë**.
- ✓ Të ardhurat e djalit, konfirmohen në vlerën totale rreth **3.000 USD**.

Gjithashtu ka deklaruar si burim:

- Dhuratë nga prindërit e bashkëshortes në shumat **5.500 Euro + 100.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën 2000 - 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalit për konsum personal (familjar), rreth **14.804.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën **01.01.2022 - 31.12.2022** janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet etj., në total **rreth 169.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën **01.01.2020 - 31.12.2022**, janë shpenzuar për udhëtimet private, në total 185.054 lekë dhe 2.570 euro, konvertuar **rreth 480.000 lekë**. Për të njëjtën periudhë, subjekti ka deklaruar edhe shpenzime për aplikimin dhe regjistrimin e djalit në programin e punësimit të studentëve “Work and Travel US”, në SHBA në shumën 1.530 USD, konvertuar **rreth 166.000 lekë**.
- ✓ Për periudhën 2009-2023, janë shpenzuar për arsimimin e personave të lidhur, në total 1.497.852 lekë, 18.194 euro dhe 4.790 USD, konvertuar **rreth 3.935.000 lekë**.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, konstatohet për subjektin Hamdi Fjora se;

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

V. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:
 1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.
- ✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Të dhënat e paraqitura në deklaratën për kontrollin e figurës janë të sakta dhe të vërteta.
- Është i vetëdijshëm se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës për kontrollin e figurës mund të sjell përjashtimin nga detyra, sipas ligjit “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të policisë së Shtetit, të Gardë së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”, të ndryshuar. Firmosur më datë 08.03.2023.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42 pika 1, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport për subjektin e vlerësimit, me nr. 1490/3 Prot, datë 18.7.2023, i përpiluar me përgjigjet e organeve ligj zbatuese dhe institucioneve shtetërore, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit **Hamdi Mehmet Fjora**.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

✚ Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 37, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligjzbatuese, si më poshtë

- a. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- b. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- c. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- d. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- e. Prokuroria e Përgjithshme;
- f. Shërbimit Informativ Shtetëror
- g. Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave
- h. Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit;
- i. Autoriteti kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar;
- j. Avokatit të Popullit
- k. Prokuroria e Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimit të organizuar (SPAK);
- l. Drejtorisë Analizës dhe Sigurimit të Personelit në AMP
- m. Drejtorisë së Inspektimit dhe Ankesave në AMP

Nga informacionet e dërguara nga institucionet e mësipërme rezulton se:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, bën me dije se:

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**. Gjatë transkriptimit në rregjistrin 1974, është hedhur gabim nga “Fjora” në “Fjora”.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, bën me dije se:
 - **Nuk rezultoi i dënuar.**
- **Institucion ligjzbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije:
 - Nuk ka të dhëna/informacione të vërtetuara që janë të përfshirë ose të dyshuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar.
 - Nuk ka të dhëna/informacione për kontakte të papërshtatshme.
 - Nuk kanë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare.
- **Institucion ligjzbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, **nuk kanë**:
 - Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakt telefonik, etj;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit Nr.10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar);
 - Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet Shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese Shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;

- Të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
- Të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.
- **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, bën me dije se:
 - Nuk disponon të dhëna.
- **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije;
 - Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
 - Nuk ka procedime penale të referuara;
 - Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që e lidhin me objektin e kërkesës.
- **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora Hamdi M. F**, bën me dije se **nuk**:
 - Është nxjerr urdhër ndalimi;
 - Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
 - Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit;
- **Institucion ligjbatues** bën me dije se për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, nuk:
 - Është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;

- Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
- Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - Rezultuan raportime për personin e lidhur znj. Lindita Fjora sipas Aneks i bashkëlidhur;
 - Nuk rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit z. Hamdi Fjora dhe personat e tjerë lidhur me të.
- **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, bën me dije se:
 - Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Sekret” lëshuar më datë 19.11.2018, e vlefshme deri më datë 18.11.2023. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
 - AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.
- **Avokati i Popullit**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, bën me dije se:
 - Nuk rezulton të ketë paturp ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht.
- **Institucion ligjbatues**, për subjektin e vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, bën me dije se:
 - Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991.

Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar. Pas diskutimeve u vendos dërgimi i kërkesës për verifikim të kontrollit të figurës në institucionet: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokurorisë së Përgjithshme, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të

Parave, Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, Autoritetit kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Kualifikuar, Avokatit të Popullit, Prokurorisë së Posaçme Kundër korrupsionit dhe Krimit të organizuar (SPAK), Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë të Personelit në AMP, Drejtorisë së Inspektimit dhe Ankesave në AMP.

Informacionet e ardhura nga institucionet e mësipërme:

Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e vlerësimit gjykojmë se:

Subjekti i vlerësimit Z. Hamdi Mehmet Fjora, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Forcës Kombëtare të Sigurisë, në Departamentin për Sigurinë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është i përshatshëm për vazhdimin e detyrës.

✚ **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

- Në mostrën e urinës marrë subjektit me kod shifror 191002, mbyllur në kontejner **nuk u zbulua** prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (kokaine), MTD (metadon), THC (canabioide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressantë), AMP (amfetaminë), MDMA (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

✚ **NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER:**

Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të figurës së subjektit të vlerësimit nëpërmjet verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit dhe korrespondenca me institucionet ligjzbatuese.

Në përfundim të veprimtarisë verifikuese të kryer në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, Trupa e Vlerësimit bazuar në parimin e kontradiktoritetit do të mbështetet edhe në shpjegimet që do të japë subjekti i vlerësimit pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancë dëgjimore.

VI . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
 - të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse në Policinë e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar
- ✚ Subjekti i vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtor i Drejtorisë së Forcës Lëvizëse Operacionale, në Departamentin për Sigurinë Publike”.

RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHETIT.

- ✚ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është struktura përgjegjëse për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit **Z. Hamdi Mehmet Fjora**. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit një raport i hollësishëm për subjektin e vlerësimit, me nr. **** prot., datë 30.06.2023, i përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale.

HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT:

Struktura e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr.**** prot., datë 30.06.2023, raportin e vlerësimit profesional.

Punonjësi i Policisë Drejtues i Parë **Hamdi Mehmet Fjora** është i emëruar në detyrën Drejtor i Drejtorisë së Forcës Lëvizëse Operacionale, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me urdhër të nr. ****, date 16.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

✚ **Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në.**

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr.****.
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. RMIS 900***;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin e arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe Performacës e konstatuar gjatë kontrolleve, inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit

nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucioneve të tjera mbikëqyrëse (Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Komisioneri Kundër Diskriminimit, KLSH).

Nga shqyrtimi dhe analizimi i burimeve të mësipërme, mbi të cilat është mbështetur ky raport vlerësimi, konstatohet dhe relatojmë si vijon:

❖ **VLËRËSIMI I NIVELIT TË ARSIMIT.**

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se subjekti ka përfunduar arsimin e lartë.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsimi i Lartë	Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve “Enver Hoxha”	1987	1991	Tiranë	Diplomë
Postmaster	Fakulteti i Shkencave Shoqërore “Albania University”	2010	2011	Tiranë	Diplomë (Studime mbi Sigurinë)

Në kuptim të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshua, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti, rezulton se subjekti, ***Përmbysh kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së aftësive profesionale.***

II.2. CERTIFIKATAT E TRAJNIMEVE, KUALIFIKIMEVE DHE MEDALJET:

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ai ka kryer trajnimet/specializimet si vijonjë:

Nr.	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji i dokumentit
1	2000	OPERACIONAL TE KRIZAVE ME PENGJE	Certifikatë
2	2001	KURS BAZE TRAJNIM I AVANCUAR	Certifikatë

3	2001	Programi i ndihmës kundër Terrorizmit	Certifikatë
4	2005	Kurs Ndërgjegjësimit ËMD	Certifikatë
5	2005	Kurs 4-mujor Formimi Profesional te punonjësve te Policisë të Rolit të Mesëm	Certifikatë
6	2007	Kurs Trajnimi Procesi i Menaxhimit te Biznesit	Certifikatë
7	2009	Kursi i menaxhimit të incidenteve kritike	Certifikatë
8	2012	Kurs Trajnimi për diversitetit strategjik	Certifikatë
9	2017	Hetimi i Krimeve te Lehta	Certifikatë

Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë 2 (dy) certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave e konkretisht:

Nr.	Viti	Lloji i certifikatës
1	2013	Certifikatë për Shërbime të Dalluara, (Urdhër nr.12, datë 13.01.2013)
2		ska

Nga verifikimi i të dhënave të administruara në dosjen personale të punonjësit, rezulton se DEKLARIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT ËSHTË I SAKTË

II.3. VLERËSIMET E PUNËS:

Në dosjen personale të subjektit, për periudhën 2018 -2023 rezulton se janë të administruara 5 (pesë) vlerësime të aftësive individuale të punës në të cilat është vlerësuar si vijon:

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 27 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 27 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 28 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 98 pikë (shumë mirë)

Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë se në periudhën 2018 – 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim, vlerësimi maksimal është 100 pikë.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standarteve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës ne grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

Bazuar në vlerësimet e mësipërmem të administruara në dosjen personale të subjektit, konkludojmë se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.

II.4. MASAT DISIPLINORE

Nga verifikimet në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare (2018 – 2022) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit,

NUK ËSHTË NDËSHKUAR ME MASË DISIPLINORE.

Për sa analizuam rezulton se deklarimi i subjektit është i saktë.

II.5. ECURIA NË KARRIERË

Subjekti **Z. Hamdi Mehmet Fjora** ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej **31 Vite e 2 muaj**. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Hamdi Fjora ka ecurinë në karrierë si vijon:

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit ose eprorit drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
17.12.2022	Aktualisht	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Drejtor i Drejtorisë së Forcës Lëvizëse Operacionale	Muhamet Rrumbullaku	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Bulevardi B.Curri	
19.10.2021	16.12.2022	Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër	Drejtor	Gledis Nano	Rruga Lëvizja e Postribës, Shkodër.	Transferuar
06.07.2021	18.10.2021	Drejtoria Vendore e Policisë	Drejtor	Ardi Veliu	Drejtoria e Vendore e	Transferuar

		Kukës			Policisë Kukës	
06.06.2018	05.07.2021	Drejtoria Vendore e Policisë Korçë	Zv/Drejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet	Ardi Veliu	Drejtoria e Vendore e Policisë Korçë	Transferuar
12.02.2018	06.06.2018	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Shef Sektori në Sektorin e Koordinimit Politikave dhe Procedurave	Ardi Veliu	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Bulevardi B.Curri	Transferuar

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhërit	Data
Drejtues	Ulje në gradë për ndryshim të strukturës organizative të policisë	Nr.2933/1, datë 18.11.2013	15.11.2013 – 30.04.2022
Drejtues i parë	Ngritur në gradë	Nr.1075, datë 05.05.2022	

Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të **Z. Hamdi Mehmet Fjora**, arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, **rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

II.6. PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE, WORKSHOP-E, SEMINARE, BOTIME BRËNDA DHE JASHTË VENDIT

Zoti Hamdi Fjora, në “FORMULARIN E AFTËSIVE PROFESIONALE PËR VLERËSIMIN KALIMTAR”, ka deklaruar së për periudhën objekt vlerësimi, është angazhuar si vijon:

- Konferencë Shkencore Ndërkombëtare “Kontributi ne Sigurinë Publike nëpërmjet arsimit”.
- Konferencë Shkencore Kombëtare “Depresioni dhe vetëvrasja” (Pjesëmarrjet Workshope, nuk administrohen në dosjen e personelit pasi nuk janë pjesë e dosjes së personelit).

Në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale Trupa e Vlerësimit konstatoi se subjekti është “I përshtatshëm” për ta ushtruar funksionin që mban.

KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit Hamdi Fjora, në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018 (të ndryshuar),

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit z. **Hamdi Mehmet Fjora**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Forcës Kombëtare të Sigurisë, në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, (të ndryshuar).
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot më datë 19.04.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Ersa Karaj
Kryesuese

Klevis Dhigoi
Relator

Erjana Pjetri
Anëtare